



ÇFARË E PENGON ZHVILLIMIN E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI?

Abstrakt

Zhvillimi i tregut të sigurimeve në Shqipëri paraqitet në nivele të ulëta, edhe pse përgjatë viteve ka njohur rritje. Pavarësisht zhvillimeve të ndodhura në këtë treg, sërish ai është ende në një nivel të ulët, krahasuar me ekonomitë e vendeve të zhvilluara. Standardi i ulët i jetesës, zhvillimi i pamjaftueshëm i tregut financiar, mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet që ka mbulimi i risqeve përmes sigurimeve, ka bërë që tregu i sigurimeve në Shqipëri të dominohet nga sigurimi i detyrueshëm dhe nga sigurimi i Jo-Jetës. Në zhvillimin e këtij tregu ndikojnë faktorët makro dhe mikro, të cilët janë të ndryshëm nga një vend në tjetrin. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tregut të sigurimeve janë të ndryshëm midis vendeve të ndryshme. Përveç faktorëve makro që ndikojnë në zhvillimin e këtij tregu, me interes është identifikimi i faktorëve mikro që e ndikojnë në këtë zhvillim. Qëllimi i këtij punimi është të zbulojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri, duke zbuluar kështu se çfarë e penguar zhvillimin e këtij tregu. Kjo realizohet përmes analizës së të dhënave të pyetësorit, duke përdorur testin statistikor *Pearson Chi-Square* i pavarësisë, i cili mundëson zbulimin e lidhjeve në rastin e variablave kategorikë. Testi do ekzekutohet duke përdorur programin SPSS. Nëpërmjet zbulimit të këtyre faktorëve krijohet mundësia që të punohet në përmirësimin e tyre dhe në këtë mënyrë të nisë zhvillimi i këtij tregu. E gjitha kjo, pasi zhvillimi i tregut të sigurimeve ka rëndësi për zhvillimin e ekonomisë të vendit, si një e tërë. Në varësi të rezultateve të analizës që realizohet në këtë punim do të jepen edhe rekomandimet përkatëse në funksion të përmirësimit të situatës.

Fjalët kyçe: Sigurime, faktorë, zhvillim, Shqipëri

Meril Canameri - Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës email: merilcanameri@gmail.com

Merlina Guni - Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës email: merlinaguni@hotmail.com

Jona Hoxha - Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës email: jona.hoxha9@gmail.com